



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1710/ 6 prot.

Datë 22.06.2026

V E N D I M

Nr. 847 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.06.2026 shqyrtoi ankesën me,

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “REXHA-CO” sh.p.k” në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k, me NIPT L01606034A dhe adresë: *Rruga “e Dibrës”*

- Ankimues:** Operatori ekonomik “REXHA-CO” sh.p.k, me Nipt M02430008M dhe adresë: Unaza e Re, *Rruga Mikel Maruli, Pallati Pienvis, Shkalla 2, Dyqani Nr.4 , Kashar, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Portual Durrës, me adresë: *Lagja nr.1, Rruga Tregtare, Durrës.*
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07-05-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 25.05.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Pc Store” sh.p.k	7,417,250.28 lekë	skualifikuar
“Rexha –co ”sh.p.k	9.680.000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 26.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar anulimin në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 01.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2026/6741 dhe me nr. protokoll 1710/2026, protokolluar me datë 01.06.2026, e operatorit ekonomik “Rexha –co ”sh.p.k, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana e tij në procedurën e prokurimit.

Në datën 02.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2026/6744 dhe me nr. protokoll 1722/2026, protokolluar me datë 02.06.2026, e operatorit ekonomik “Pc Store” sh.p.k, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana e tij në procedurën e prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1710/1 prot, datë 02.06.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga “REXHA CO” SHPK si dhe gjithashtu formularin me nr. 1722/1 datë 04.02.2026 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur “PC STORE” shpk .

II.8. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr. 2000 prot., datë 09 .06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1710 /3 prot., datë 11 .06.2026, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën objekt - anikimi, vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Rexha CO” SHPK vendim i cili ka ardhur dhe nëpërmjet sistemit elektronik nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Rexha CO” SHPK.

II.9. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr. 1927 prot., datë 04 .06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1722/2 prot., datë 08 .06.2026, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën objekt - anikimi, vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC Store ” sh.p.k nga ku rezulton, se KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara “Pc Store” shpk , sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Rexha CO” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1. 1. Nëpërmjet shkresës nr. 2000 prot., datë 09 .06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1710 /3 prot., datë 11 .06.2026, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën objekt - anikimi, vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Rexha CO” SHPK vendim i cili ka ardhur dhe nëpërmjet sistemit elektronik nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Rexha CO” SHPK.

VENDOSI :

[... *Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rexha CO” shpk ...*]

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave,*

Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 2000 prot., datë 09 .06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1710 /3 prot., datë 11 .06.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Rexha CO” shpk, rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues , për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rexha CO” shpk.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “PC Store ” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit me arsyen se: ...[1. AK Autoriteti Portual Durres ne vendimin per skualifikimin e OE PC STORE, citon se: Operatori ekonomik skualifikohet pasi oferta teknike e paraqitur nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik/katalogut të paraqitur rezultojnë mospërputhje në disa elementë thelbësorë të pajisjes, konkretisht: tipologjia e motorit, sistemi i transmetimit, indeksi i mbrojtjes IP, mungesa e provimit të portës USB-C, gjatësia e krahut/traut të barrierës, kapaku i sipërm, aksi i krahut, trajtimi antikorroziv i pjesëve mekanike, furnizimi me energji elektrike dhe niveli i zhurmës. Në dokumentet e tenderit janë kërkuar specifikime teknike minimale dhe të detyrueshme, ndërsa dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk provon përmbushjen e plotë të tyre. Për disa prej kriterëve, pajisja e ofertuar rezulton me parametra më të ulët ose të ndryshëm nga ato të kërkuara, ndërsa për disa të tjera mungon dokumentimi

teknik i nevojshëm për të vërtetuar përputhshmërinë. Arsyet e skualifikimit sipas KVO lidhen me piken specifikimet teknike, të cilat provohen përmes pikës 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta të kualifikimit në DST: 5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë: a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe eëb-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar. b. c. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit. Nr. i faqes në katalog referuar Nr. Identifikues të artikullit të ofruar sipas listës të shënuar me një shenjë dalluese. Argumentimi për këtë kriter sipas Procesverbalit të Argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kushteve për kualifikim: Argumentim: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik të ndryshuar. Për të përmbushur kërkesat teknike dhe këtë kriter PC Store ka dorëzuar në SPE Dokumentacionin si më poshtë: 1. Deklaratë Ofertë teknike (2 faqe), në të cilin janë detajuar sipas kërkesës së AK në Formë Tabelare të dhënat e ofertes teknike: a. Emërtimi i produktit b. c. d. e. 2. a. b. c. Emri, adresa eëbsite e kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar Emri i katalogut, prospektit Nr. i faqes së katalogut prospektit Nr. identifikues i Produktit Katalog dhe deklarata (28 faqe), të përbërë nga: Katalog për Barrierat LBA 63 Toll Flex Katalog për Tra LBA 63 Toll Flex Deklaratë e distributorit Parkit mbi përputhshmërinë e pajisjeve me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Kundershtojmë skualifikimin e ofertes sone për kërkesat teknike dhe kriterin 2.3.5 si një vlerësim i paligjshëm, i kryer në tejkalim të kompetencave të KVO dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021. Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave 2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Sipas bazës ligjore dhe nenligjore, duhet që Autoriteti Kontraktor të kryente vlerësim duke iu referuar vetëm kriterëve që ka përcaktuar vetë në Dokumentat e Tenderit, konkretisht në kriteret e përgjithshme dhe kriteret e vecanta. 1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të ofertes së OE PC STORE shpik për pretendimin e mosplotësimi të specifikimeve teknike, vlerësojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktor është i pabazuar në ligj, në provë dhe në dokumentacionin teknik të paraqitur në procedurë, për sa kohë është mbështetur në një analizë të pjesshme të dokumentacionit dhe jo në shqyrtimin e tij në tërësi e vet. Autoriteti Kontraktor ka arritur në përfundimin se oferta teknike e paraqitur nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara, duke pretenduar se nga shqyrtimi i katalogut teknik rezultojnë mospërputhje lidhur me tipologjinë e motorit, sistemin e transmetimit, indeksin e mbrojtjes IP, portën USB-C, gjatësinë e krahut të barrierës, kapakun e sipërm, aksin e krahut, trajtimin antikoroziv të pjesëve mekanike, furnizimin me energji elektrike dhe nivelin e zhurmës. Ky konkluzion është arritur mbi bazën e një metodologjie të gabuar vlerësimi, pasi Autoriteti Kontraktor ka analizuar në mënyrë selektive vetëm katalogun standard të produktit, ndërkohë që operatori ekonomik ka paraqitur një paketë të plotë dokumentacioni teknik, ku përfshihen katalogu teknik, dokumentacioni shoqëruar dhe deklarata teknike e distributorit të autorizuar/prodhuesit, e lëshuar posaçërisht për procedurën objekt prokurimi. Në kuptim të

nenit 21 te Ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik , autoritetet kontraktore kane detyrimin te garantojne respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, proporcionalitetit, konkurrences dhe transparences. Keto parime nuk mund te konsiderohen te respektuara kur dokumentacioni teknik vleresohet ne menyre fragmentare, duke i dhene vlere vetem nje dokumenti dhe duke mos marre parasysh dokumente te tjera teknike te paraqitura ne oferte, te cilat kane pikerisht funksionin e provimit te perputhshmerise se produktit me kerkesat e procedures. Ne rastin konkret, Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer nje analize te integruar te dokumentacionit teknik. Nga vete permbajtja e arsytimit te skualifikimit rezulton se vleresimi eshte mbeshtetur pothuajse ekskluzivisht mbi katalogun teknik standard te produktit, pa kryer asnje analize mbi deklaraten teknike te paraqitur nga distributori i autorizuar PARKIT (per te cilin eshte paraqitur dhe dokumentacioni provues i lidhjes me Prodhuesin LBA), dokument i cili eshte leshuar posaçerisht per produktet e ofertuara ne kete procedure prokurimi dhe ka per qellim te konfirmoje karakteristikat teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. Eshte e rendesishme te evidentohet se kataloget teknike te prodhuesve nuk jane dokumente qe hartohen sipas kerkesave te nje autoriteti kontraktor te caktuar. Kataloget teknike jane dokumente standarde te prodhuesit, te destinuaraper perdorim te brendshem apo nderkombetar dhe per nje game te gjere konfigurimesh, klientesh dhe tregjesh. Operatoret ekonomike nuk jane autoret e ketyre dokumenteve dhe nuk kane asnje mundesi faktike apo juridike te nderhyjne ne permbajtjen e tyre, t i modifikojne, plotesojne apo riformulojne ato sipas kerkesave specifike te nje procedure te caktuar prokurimi. Pikerisht per kete arsye, ne praktiken tregtare dhe teknike, prodhuesit dhe distributoret leshojne deklarata teknike, certifikime dhe konfirmime te posaçme per procedurat e prokurimit, me qellim evidentimin dhe konfirmimin e karakteristikave specifike qe nuk pasqyrohen domosdoshmerisht ne katalogun standard. Ne kete kuptim, mungesa e permendjes se nje karakteristike te caktuar ne katalog nuk mund te interpretohet automatikisht si mungese e vete karakteristikes teknike. Nje perfundim i tille do te ishte teknikisht dhe juridikisht i pasakte. Ne te kundert, vete paraqitja e deklarave teknike te prodhuesit apo distributorit do te humbiste çdo funksion praktik dhe juridik ne procedurat e prokurimit publik. Ne rastin konkret, deklarata teknike e paraqitur nga distributori i autorizuar PARKIT eshte dokument teknik me vlere provuese dhe konfirmon shprehimisht perputhshmerine e pajisjes se ofertuar me kerkesat e Autoritetit Kontraktor, perfshire elementet qe AK pretendon se nuk rezultojne te pasqyruar ne katalog. Megjithate, ne vendimin e skualifikimit nuk gjendet asnje analize mbi kete dokument, nuk gjendet asnje arsyetim perse ai nuk eshte konsideruar i vlefshem dhe nuk gjendet asnje reference qe te justifikojë zhvleresimin e tij. Po ti referoheni Dokumentit Deklarate Oferta teknike , te ngarkuar ne SPE, duket qarte se per te permbushur referencat mbi numrin e faqes në katalog referuar numrit Identifikues te artikullit të ofruar sipas listës i shenuar me nje shenje dalluese, PC Store ka deklaruar si reference faqet perkatese te katalogeve dhe Deklarates se Parkit, element ky i pa marre parasysh nga AK. Ky trajtim diskriminues bie ndesh me percaktimet e pikes 5 te nenit 36 Specifikimet Teknike te LPP. Në nenin 36 Specifikimet teknike të ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se: 1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë

të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që tu japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës a , referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës b të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat a dhe b të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët ose ekuivalenti i tij/saj . 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët ose ekuivalente . 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës b të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 Për prokurimin publik , i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatori Ekonomik PC Store, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, ka vertetuar që zerat e ofruara janë në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Referuar Vendimeve të Unifikuara të KPP mbi trajtimin e ofertave teknike të Operatoreve Ekonomike, evidentohet i njëjti qëndrim i paanshem dhe ligjor: Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve

të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi. Është detyrë e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave/shërbimeve të ofertuara prej tyre me ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Vendimi i skualifikimit nuk reflekton asnjë shqyrtim të kësaj deklaratë në aspektin e përmbajtjes, të vlefshmërisë, të fuqisë provuese dhe të shkaqeve pse ajo nuk u mor në konsideratë. Autoriteti kontraktor ne kundërshtim me ligjin ka zgjedhur të mbështetet ekskluzivisht në katalog, pa shpjeguar arsyen pse ka zgjedhur të injorojë dokumentin tjetër teknik të paraqitur bashkë me ofertën. Ne perfundim Autoriteti Kontraktor ka vepruar ne shkelje te dispozitave ligjore ne fuqi duke skualifikuar oferten teknike si jo ne perputhje me Kerkesat e DST. 2. Persa me lart shpjeguar arsyet perse Oferta e PC Store eshte ne perputhje me kerkesat e tenderit, dhe per rrjedhoje duhet kualifikuar, si dhe faktet qe e bejne vendimin e KVO per skualifikim, ne shkelje te parimit te trajtimit te barabarte ne procedurat e prokurimit publik. Per te bere me te qarte vleresimin e pasakte te AK, deshirojme te ndalemi dhe ne nje analize me te thelluar mbi elementet teknike te katalogeve te paraqitur, per te cilat AK pretendon se nuk provohen, por qe faktikisht rezultojne te dokumentuara ne katalog dhe ne deklarate. Tabela: Elementët e pretenduar nga AK dhe trajtimi në Deklaratën Teknike të PARKIT Nr. 1 Pretendimi i AKKu trajtohet në Deklaratë Tipologjia e motorit Citimi i saktë Pika 8 e kërkesave strukturore + Parametri nr. 8 i tabelës Motor elektrik DC pa fuqia dhe Motor elektrik pa fuqia me kuti ingranazhesh, çift rrotullues minimal 60 Nm 2 Sistemi i transmetimit Pika 8 e kërkesave strukturore Sistem transmetimi sekondar me mekanizëm shufër lidhëse-manivelë, që siguron kyçje të plotë mekanike në të dy pozicionet ekstreme (hapur/mbyllur) 3 Indeksi i mbrojtjes IP Paragrafi hyrës + Parametri nr. 10 i tabelës Vlerësim minimal mbrojtjeje IP55 kundër pluhurit dhe hyrjes së ujit dhe IP55 ? i mbrojtur nga pluhuri dhe spërkatjet e ujit 4 Mungesa e provimit të portës USB-C komunikimi Ethernet dhe portë USB-C 5 Gjatësia e krahut të barrierës Pika 10 e kërkesave strukturore Specifikimet e Krahut të Bumit, pika 8 Portë Gjatësia: 3.5 m Trajtuar gjithashtu ne katalogun Teknik te modelit LBA 63 PG FLEX percakton shprehimisht se pajisja eshte krah barriere me gjatesi deri ne 3.5 m, ndersa ne tabelen teknike te produktit percaktohet po ashtu gjatesi maksimale e krahut 3.5 metra. 6 Kapaku i sipërmPika 3 e kërkesave strukturore Aksi i krahut Mbulesë e sipërme e lëvizshme e prodhuar nga aliazh alumini i derdhur dhe e kyçshme me një siguri çelës Trajtuar gjithashtu ne katalogun Teknik Kapaku i siperm: flete e trashe alumini 2 mm 7 Pika 5 e

kërkesave strukture Boshti i krahut i montuar në dy kushineta të lubrifikuara përgjithmonë. Pajisja duhet të lejojë ndryshimin e pozicionit të krahut (djathtas ose majtas) pa modifikime strukture Trajtuar gjithashtu në katalogun Teknik Automated controlled anti-rebound & rehinging , çka demonstroi ekzistencën e mekanizmit automatik të riangazhimit të krahut 8 Trajtimi antikorroziv i pjesëve mekanike Pika 6 e kërkesave strukture pjesët mekanike të brendshme të trajtuara për rezistencë ndaj korrozionit Të gjitha Trajtuar gjithashtu në katalogun Teknik Flete Celiku e trajtuar me kataforese , një proces industrial i njohur dhe i përdorur gjerësisht për mbrojtjen e strukturave metalike ndaj korrozionit 9 Furnizimi me energji elektrike Parametri nr. 1 i tabelës + Parametri nr. 2 Njëfazor 230 V / 110 V, 50/60 Hz, me lidhje tokëzimi PE dhe Maksimumi 500 Ë / Nominale 60 Ë 10 Niveli i zhurmës Parametri nr. 11 i tabelës Më pak se 70 dB(A), e matur në 1 m distancë nga sipërfaqja e pajisjes, në 1.60 m mbi nivelin e tokës, sipas standardit ISO 3744 PC Store ka operuar brenda kuadrit ligjor në fuqi, ku përmes dokumentacionit të plotë Teknik të përbërë nga Deklarata Oferta Teknike, Kataloget Teknike dhe deklarates teknike të distributorit të autorizuar Parkit, ka provuar se zgjidhja e propozuar përmbush kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike. Për më tepër, nëse Autoriteti Kontraktor kishte dyshime mbi mënyrën e përmbushjes së ndonjë specifikimi teknik apo mbi interpretimin e dokumentacionit të paraqitur, legjislacioni i prokurimit publik i jepte atij mundësinë të kërkonte sqarime. Konkretisht, nën 82 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik parashikon se: Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit... Megjithatë, në rastin konkret Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar asnjë sqarim, megjithatë në oferte ekzistonte dokumentacion shtesë teknik dhe deklarate të posaçme të distributorit të cilat trajtonin pikërisht elementet që AK pretendon se nuk rezultojnë në katalog. Po aq problematik është edhe fakti që një pjesë e vendimit të kualifikimit nuk përmban analizë individuale për secilin specifikim teknik. Në vend të një analize teknike të individualizuar, vendimi kufizohet në formulime të përgjithshme si Për disa prej kritereve, pajisja e ofertuar rezulton me parametra më të ulët ose të ndryshëm nga ato të kërkuara, ndërsa për disa të tjera mungon dokumentimi teknik i nevojshëm për të vërtetuar përputhshmërinë. Pa shpjeguar se mbi çfarë baze teknike apo ligjore është arritur ky përfundim. Për rrjedhojë, rezulton se Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer një vlerësim të plotë, objektiv dhe të arsyetuar të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik, ka injoruar deklaratën teknike të distributorit/prodhuesit të autorizuar, ka barazuar gabimisht mungesën e një reference në katalog me mungesën e vetë karakteristikës teknike dhe ka arritur në një përfundim që nuk mbështetet as në analizë teknike dhe as në prova objektive. Për më tepër, i transparencës, i parashikuar nga nën 21 i Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik , nuk gjen zbatim të plotë vetëm nëpërmjet publikimit formal të vendimeve, por kërkon që çdo veprim dhe vendim i autoritetit kontraktor të jetë i verifikueshëm, i kuptueshëm dhe i kontrollueshëm në përmbajtjen e tij. Ky standard nuk përmbushet kur kualifikimi i operatorit ekonomik mbështetet në formulime të përgjithshme dhe mohuese, pa u shoqëruar me një analizë konkrete dhe të individualizuar të dokumentacionit të paraqitur në ofertë. Për sa më sipër, vlerësojmë se arsyeja e skualifikimit është e pabazuar në ligj dhe në prova, në kundërshtim me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik , dhe për këtë arsye nuk duhet të merret parasysh. Si OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kërkojmë shfuqizimin e vendimit të skualifikimit dhe rivlerësimin e ofertes së operatorit ekonomik PC STORE shpk mbi bazën e të gjithë dokumentacionit teknik të paraqitur në procedurë.

KONKLuzion: Duke qene se e konsiderojme skualifikimin e ofertes se PC STORE si te pabazuar ne ligj e ne prova, kundershtojme anulimin e procedures, kerkojme pranimin e ankeses se PC STORE ne proceduren e prokurimit publik nr REF-84434-05-06-2026 me objekt Blerje Barrierash me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, e zhvillaur nga Autoriteti Kontraktor Autoriteti Portual Durres..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në pikën 2.3.4 në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, dhe “shtojca 7”, në dokumentet standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

2.3.4 Për materialet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen.

Shtojca 6 Specifikimet teknike

Pajisja duhet të jetë e destinuar për përdorim universal në aplikacione të ndryshme, duke përfshirë menaxhimin e trafikut rrugor, zonat e parkimit, ambientet industriale. Sistemi duhet të ofrojë performancë të lartë operacionale dhe nivel të lartë sigurie funksionale.

Struktura e jashtme duhet të jetë ndërtuar tërësisht nga alumin rezistent ndaj korrozionit, me dizajn të lehtë por të qëndrueshëm, dhe duhet të ketë indeks mbrojtjeje minimum IP55 ndaj pluhurat dhe ujit. Pajisja duhet të ofrojë mundësi ndriçimi të integruar me brez LED me gjatësi të plotë, si dhe mundësi zgjedhjeje të ngjyrës sipas kodeve standarde RAL : Portokalli , E kuqe , Gri , E Bardhë

Kërkesat strukturore dhe mekanike:

1. Dyert anësore duhet të jenë të lëvizshme dhe të prodhuara nga alumin i ekstruduar.
2. Panelet duhet të jenë të prodhuara nga alumin i ekstruduar, me mundësi integrimi të brezit LED me gjatësi të plotë.
3. Kapaku i sipërm duhet të jetë i lëvizshëm, i prodhuar nga lidhje alumini e derdhur me injektim dhe të mbyllet me çelës sigurie.
4. Baza e pajisjes duhet të jetë e prodhuar nga lidhje alumini e derdhur me injektim.
5. Aksi i krahut duhet të jetë i montuar mbi dy kushineta me lubrifikim të përhershëm. Pajisja duhet të lejojë ndryshimin e pozicionit të krahut (djathtas ose majtas) pa ndërhyrje strukturore.
6. Të gjitha pjesët mekanike të brendshme duhet të jenë të trajtuara për rezistencë ndaj korrozionit.
7. Ekuilibrimi i krahut duhet të realizohet nëpërmjet sistemit me sustë mekanike.
8. Grupi elektromekanik duhet të përfshijë:
 - Motor elektrik pa furça (brushless DC).
 - Sistem transmisioni dytësor me biel-manivele, duke garantuar bllokimin mekanik të plotë në të dy pozicionet ekstreme (hapur/mbyllur).
 - Mundësi opsionale rilëshimi automatik të krahut në rast ndërprerje elektrike.
9. Pajisja duhet të ketë levë çlirimi manual për operim në rast ndërprerje elektrike.
10. Logjika elektronike e kontrollit duhet të jetë e konfigurueshme dhe të mbështesë opsione të ndryshme kontrolli dhe aksesori shtesë, duke përfshirë:

- Port komunikimi Ethernet dhe port USB-C.
- Kontakte informacioni të rregullueshme, të cilat tregojnë: (a) statusin e pozicionit të barrierës (hapur/mbyllur); (b) statusin e sensorëve të prezencës; (c) mundësi kontrolli master-slave për dy barriera të kundërta, ku lëvizja e njërës kontrollohet nga tjetra.

11. Duhet të jetë e pajisur me me mekanizëm manual për lirimin anësor (sëing-off), si dhe me pajisje automatike për riangazhimin/rikthimin e krahut, të vendosur në pjesën e pasme ose në pjesën e përparme.

KËRKESAT TEKNIKE MINIMALE

Nr.	Parametri Teknik	Kërkesa Minimale e Detyrueshme
1	Furnizimi me energji elektrike	Monofaz 230 V / 110 V, 50/60 Hz, me lidhje tokë (PE)
2	Konsumi i energjisë	Maksimumi 500 Ë / Nominal 60 Ë
4	Temperatura e funksionimit	Ndërmjet -20°C dhe +55°C , (me opsion ngrohjeje termostatike)
5	Lagështia relative e ambientit	Maksimumi 95%, pa kondensim
6	Hapja maksimale e kalimit	Nga 2 deri në 4 m
7	Koha minimale e hapjes/mbylljes	E rregullueshme nga 0.7 sekonda në modalitet shpejtësi të lartë
8	Motori	Motor elektrik pa furça (brushless) me ingranazhë, çift rrotullues minimal 60 Nm.
9	MCBF (Cikle mesatare ndërmjet defekteve)	Minimumi 10,000,000 cikle,
10	Indeksi i mbrojtjes (IP)	IP55 — i mbrojtur ndaj pluhurat dhe spërkatura të ujit
11	Niveli i zhurmës	Më pak se 70 dB(A), i matur në distancë 1 m nga sipërfaqja e pajisjes, në lartësi 1.60 m mbi tokë, sipas standardit ISO 3744
12	Pajtueshmëria me standardet	Pajisja duhet të jetë e certifikuar CE
13	Krahu	Mekanizëm manual për lirimin anësor (sëing-off), si dhe me pajisje automatike për riangazhimin/rikthimin e krahut, të vendosur në pjesën e pasme ose në pjesën e përparme.

Specifikimet Teknike të Traut

1. Mbulesë te papërshkueshme nga uji.
2. Shirit ngjites reflektues

3. Mbështjellës transparent termo-tkurrës.
4. Pjesë të formësuara gjysmë rrethore nga polistireni.
5. Tub me fibra karboni.
6. Krah që i reziston goditjeve deri në 100 km/h.
7. Goditje deri në 60 km/h pa dëmtuar xhamin e përparmë.
8. Gjatesia 3.5 m

Ky krah duhet të jete rezistent ndaj goditjeve, duke parandaluar dëmtimin e pajisjes si dhe të automjeteve, duke përmirësuar sigurinë e përdoruesit. Krah i portës duhet të jete i përbërë nga një tub me fibra karboni, i mbuluar me forma të formësuara gjysmë-rrethore nga polistireni, të mbrojtura me mbështjellës termo-tkurrës.

I gjithë montimi duhet të jete i mbuluar me një mbulesë të papërshkueshme nga uji, e cila duhet të ketë shirita reflektues dhe të jete e siguruar.

Në fundin e krahut duhet të jete i montuar adaptatori i përshtatshëm (mbajtëse krah) për t'u përshtatur me mekanizmin e lëkundjes së krahut.

Afati lëvrimit të paisjeve:

60 Ditë

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas dokumentit ngarkuar në SPE: “Lista e mallrave”

Objekti: “Blerje Barrierash”

Afatet e lëvrimit: 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Blerje Barrierash

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Barrierë	Cope	11
2	Tra 3.5 m	Cope	11

III.2.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve publike rezulton, se operatori ekonomik “Pc Store ” SHPK, në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka paraqitur:

 [Katalog dhe deklarata.pdf \(10,28 MB\)](#)

- Katalog LBA 63 TOLL Flex

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor. përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor. 7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.”

III.2.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në

kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të 20 kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.2.7. Në nenin 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]”

III.2.8 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e

përpyesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për për zgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton, se duke u rikthyer tek pretendimi i operatorit ekonomik “Pc store” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.4 të dokumentave standarte të tenderit, ku paashikohet se: *“Për materialet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen.”*. Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se, operatorët ekonomikë ofertues për artikujt objekt prokurimi, ka paraqitur - Katalog LBA 63 TOLL Flex. KPP vlerëson se nga verifikimi i katalogut të paraqitur - Katalog LBA 63 TOLL Flex, rezulton se në shtojcën 6, është kërkuar nga autoriteti kontraktor **“10 . Indeksi i mbrojtjes (IP), IP55 — i mbrojtur ndaj pluhurat dhe spërkatura të ujit”**, nga verifikimi i katalogut teknik të paraqitur nga aoperatori ekonomik “Pc store” shpk , rezulton se **Indeksi i mbrojtjes IP rezulton IP 54** e përcaktuar kjo e fundit në katalogun e dorëzuar në sistemin elektronik në SPE.

Për sa më sipër KPP vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik për përmbushjen e kriterit si më sipër cituar, nuk është i vlefshëm në përmbushje kështu të specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III. 3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Pc Store” SHPK , KPP vlerëson se përsa kohë statusi i operatorit ekonomik do të vijojë të qëndrojë i skualifikuar trajtimi i pretendimeve të tjera të ankimuesit në lidhje me pikat tjera të pretendimeve nuk do të merren në shqyrtim për efekt të Parimit Ekonomisë Administrative .

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

- 1.Të mbyllë çështjen për ankesën e pranuar të operatorit ekonomik “REXHA-CO” sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
- 2.Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK,për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
- 3.Autoriteti Kontraktor te rivlersoje proceduren e prokurimit publik sipas konsatimeve te ketij vendimi, dhe vendimit të KSHA.
- 4.Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
- 5.Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “REXHA-CO” SHPK.
- 6.Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK.
- 7.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
- 8.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

